



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 14. 02. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 10:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Enis Kervan, Ramë Buja, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini, Nexhat Daci, dhe Dragisa Miric. Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi

Petrit Hysa –OSBE
Lumnije Murati-ZPK

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Mbledhja konstituive e Komisionit
2. Fushëveprimi i Komisionit
2. Të ndryshme

1. Mbledhja Konstituive e Komisionit

Sabri Hamiti lidhur me konstitutimin e Komisionit për Punë të Jashtme, tha se Komisioni është themeluar në seancën e Kuvendit, ndërsa kjo është mbledhja e parë njohëse e Komisionit, kryetar i Komisionit është Sabri Hamiti, zëvendëskryetarë të Komisionit janë Xhavit Haliti dhe Enis Kervan, anëtarë të Komisionit janë Ramë Buja nga PDK, Ramadan Avdiu nga PDK, Eqrem Kryeziu nga LDK, Lutfi Haziri nga LDK, Ibrahim Gashi nga AKR, Nexhat Daci nga LDD dhe Dragisa Miric nga SLS.

2. Fushëveprimi i Komisionit

Sabri Hamiti për Komisionin për punë të jashtme tha se, me këtë emërtim funksionon dhe themelohet për herë të parë tani në Kuvendin e Kosovës, përdërisa në dy legjislaturat e para ka funksionuar një komision i përbashkët për bashkëpunim ndërkombëtarë dhe integritet euro-atlantike. Zhvillimet politike të pritshme, zhvillimet konstituive të Kuvendit, këshillimet ndërkombëtare që i kemi pasur, tha se kanë kërkuar që edhe ne të kemi një Komision për punë të jashtme si të gjitha parlamentet e tjera.

Si pika themelore të fushë veprimtarisë së Komisionit tha se, përcaktohen këto veprime;

- Në koordinim me Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit, ndërton bashkëpunimin me parlamentet e shteteve dhe promovon anëtarësimin e Kuvendit të Kosovës në organizatat parlamentare regjionale e ndërkombëtare.
- Shoqëron Kryetarin e Kuvendit në takimet parlamentare ndërkombëtare.
- Ratifikon në bllok ose ndaras traktatet ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruaj.
- Përcjell negociatat e udhëhequra nga Qeveria lidhur me bashkëpjesëmarrjen e saj në traktatet e reja dhe nis debatin për ratifikimin e tyre.
- Mbikëqyr nxjerrjen e ligjeve për punë të jashtme dhe për imunitetet diplomatike.
- Përcjell themelimin e Ministrisë për Punë të Jashtme dhe të rrjetit diplomatik të Kosovës.
- Mbikëqyr veprimet e Qeverisë në planin e politikës së jashtme.
- Shoqëron Ministrin e Jashtëm në takime të caktuara, të rëndësishme.
- Bashkëpunon me komisionet homologe të parlamenteve të vendeve të tjera.
- Promovon diplomacinë parlamentare të Kuvendit të Kosovës .

Disa nga pikat e fushë veprimtarisë tha se janë tani në funksion, e disa priten të rimerren në muajt ardhshëm. Në mbledhjet e ardhshme do të përpiqemi t'a caktojmë një program më të detajuar të veprimit.

Ibrahim Gashi tha se konsideroj se ky Komision, është një Komision shumë i rëndësishëm në vendet e zhvilluara të botës, dhe luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve të shteteve.

Me definimin e statusit tha se do të sqarohet fushë veprimtaria e Komisionit më shumë, krijimi i Ministrisë për Punë të Jashtme po ashtu do ta nxjerr në pah rolin e këtij Komisioni, i cili do të forcohet me rolin e shtetit të Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke pas parasysh fuqizimin e tij ekonomik, stabilitetin politik dhe lidhjet që do t'i krijoj me vendet e botës.

Xhavit Haliti përkrah pikat e fushë veprimtarisë së Komisionit, ndërsa si pikë shtesë propozon që Komisioni t'a ketë parasysh angazhimin e tij në raport me diasporën shqiptare sepse shtoi se, është një numër i madh i tyre, angazhimi i të cilëve ka qenë i jashtëzakonshëm dhe për një periudhë të gjatë kohore, dhe njëkohësisht kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në procesin e angazhimeve për pavarësinë e Kosovës. Ky emigracion pas luftës, tha se ka mbet jashtë fokusimit të institucioneve të Kosovës dhe për të ndërtuar raportet me ta siç kanë qenë gjerë më tani, Komisioni duhet të ketë nisma të kontakteve me migracionin. Në fund shtoi se fushë veprimtaria e Komisionit është shumë e gjere, dhe për realizimin e këtyre objektivave duhet të angazhohemi të gjithë anëtarët, me nga një punë shtesë konkrete.

Enis Kervan tha se pajtohem plotësisht me z. Xh. Haliti, për angazhimin rreth diasporës së Kosovës dhe propozoi si pikë të veçantë në fushë veprimtarinë e Komisionit, të jetë bashkëpunimi me vendet ku jetojnë shqiptarët dhe komunitetet e tjera të Kosovës.

Sabri Hamiti duke e pas parasysh se Kuvendi gjendet në afatin e përshpejtuar të miratimit të buxhetit të Kosovës, kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit për të kërkuar një vijë buxhetore brenda buxhetit të Kuvendit, për financimin e veprimtarisë së Komisionit.

Ardian Gjini mendon se, sikur të kishte ky Komision një vijë buxhetore, kishte me qenë më lehtë të punoj dhe zhvilloj, aktivitetet e veta.

Enis Kervan tha se në këtë fazë në të cilën gjendet Kosova dhe me pavarësimin e saj, do të kemi punë shumë më tepër, prandaj patjetër është e nevojshme një vijë buxhetore për Komisionin.

Nexhat Daci tha se kërkesa për ndarjen e një vije buxhetore për Komisionin, mendoj se është plotësisht e porealizueshme, sepse Komisioni është konstituuar me shumë vonesë, kurse buxheti ka hyrë në fazën përfundimtare të miratimit dhe do të miratohet me procedurë të përshpejtuar. Kjo do të ishte procedurë normale për një parlament normal dhe një vend normal, ndërsa ne nuk i kemi asnjërën nga këto parametra.

Mendon se është më mirë që kërkesa për ndarjen e një vije buxhetore brenda Kuvendit të ngritët mbi bazën e fushëveprimit të Komisionit, të planifikimit të aktiviteti për këtë vit, në Kryesinë e Kuvendit, pasi që shumica e anëtarëve të Komisionit janë anëtarë të Kryesisë do të jetë më lehtë të realizohet.

Në fund shtoi se është brengosës raporti nënçmues i Parlamentit në tërësi, nga se Qeveria sillet sikur e ka zgjedhur Kryesinë e Kuvendit dhe konstituuar Kuvendin, dhe jo e kundërta, ndërrimi i këtij raporti do ta funksionalizonte Kuvendin e pastaj edhe komisionet.

Sabri Hamiti propozoi që anëtarët e Komisionit Xh.Haliti, N.Daci, I.Gashi dhe kryetari i Komisionit, Sabri Hamiti, për mbledhjen e ardhshme të Komisionit të propozojnë një plan pune, me veprimet prioritare për muajt e ardhshëm.

Si kompetencë tjetër e Komisionit shtoi se, do të mundë të ishte edhe verifikimi i përfaqësimit jashtë vendit, që është praktikë e disa parlamenteve, ndërsa tek ne kjo çështje kalon përmes Kryesisë së Kuvendit. Komisioni nuk ka ndonjë interes të veçantë të merret me këtë çështje, vetëm nëse do ti jepet për detyrë.

Komisioni pas diskutimeve nxori këto

P e r f u n d i m e

1. Miratohet fushëveprimi i Komisionit për Punë të Jashtme.
2. Autorizohen anëtarët e Komisionit Xhavit Haliti, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi dhe kryetari i komisionit Sabri Hamiti, që për mbledhjen e ardhshme të Komisionit të propozojnë një plan pune me veprimet prioritare për muajt e ardhshëm.
3. Komisioni të insiston me fuqinë përfaqësuese që e ka përmes Kryesisë së Kuvendit, për ndarjen e një vije buxhetore nga buxheti i Kuvendit, me qëllim të përmbushjes së detyrave që dalin nga fushë veprimtaria e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 10,50 min.

Kryetari i Komisionit
Sabri Hamiti

Procesmbajtësi
Minire Hasani

